



UDHËZIM

Nr. 59, datë 24.12.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 33, DATË 19.9.2014 “PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË PUBLIK
E PRIVAT NË VITIN AKADEMIK 2014-2015 TË STUDENTËVE QË TRANSFEROJNË
STUDIMET NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË TË CILËVE
U ËSHTË HEQUR LICENCA”**

Në mbështetje të nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 539, datë 6.8.2014 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë”, vendimit nr. 539, datë 6.8.2014 të Këshillit të Ministrave “Për heqjen e licencës disa institucioneve private të arsimit të lartë”, Vendimit nr. 716, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e transferimit të studimeve dhe tarifat e shkollimit, për studentët që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë, të cilave u është hequr licenca, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2014 – 2015”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. Udhëzimi nr. 33 datë 19.9.2014 “Për procedurat e pranimit, në institucionet e arsimit të lartë publik e privat në vitin akademik 2014-2015 të studentëve që transferojnë studimet nga institucionet private të arsimit të lartë të cilëve u është hequr licenca” të ndryshojë si më poshtë:

1. Pika 8 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Komisionet e vlerësimit dhe të ekuivalentimit të ngritur pranë IAL-ve publike kryejnë vlerësimin dhe ekuivalentimin e dosjeve të kandidatëve që rezultojnë të rregullta me qëllim ekuivalentimin e rezultateve individuale të secilit prej studentëve ndjekjes së programeve përkatëse të studimit në IAL-të private të cilëve iu është hequr licenca, deri në orën 12:00 të datës 5 janar 2015. Ekuivalentimi individual bëhet duke u bazuar në ekuivalentimin paraprak për çdo program studimi.”

2. Pika 10 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Dekanatet e fakulteteve bazuar në vendimin e komisionit të vlerësimit dhe ekuivalentimit, shpallin, brenda datës 5 janar 2015, të dhënat për çdo kandidat, kreditet e ekuivalentuara, detyrimet dhe lëndët e pashlyera, si dhe vitin në të cilin transferohet.”

3. Pika 11 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Në periudhën deri në datën 9 janar 2015 bëhet regjistrimi i studentëve pranë sekretarive mësimore të fakultetit përkatës dhe paguhet tarifa përkatëse.”

4. Pika 13 e kreut IV të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“IAL-të publike i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së listën e studentëve të regjistruar, brenda datës 13 janar 2014, me qëllim pajisjen e tyre me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit.”

5. Pika 4 e kreut VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“Në IAL-të private aplikantët regjistrohen përfundimisht brenda datës 9 janar 2015.”

6. Pika 5 e kreut VI të udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“IAL-të private i dërgojnë MAS-it dhe AKP-së brenda datës 13 janar 2015, në rrugë postare, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format *excel*, me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date, nuk do të



procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit.”.

7. Kreu VIII i udhëzimit të ndryshojë si më poshtë:

“AKP pajis studentët, për të cilët IAL-të publike dhe private kanë përcjellë listat me të dhënat përkatëse brenda afateve të parashikuara në këtë udhëzim, me numrin e matrikullimit, dhe ia komunikon atë me shkresë zyrtare IAL-së përkatëse brenda datës 10 shkurt 2015. Në rastet kur një student nuk mund t’i jepet numri i matrikullimit, AKP i kërkon IAL-së ta çregjistrojë atë. IAL çregjistron studentin brenda 10 ditësh kalendarike nga marrja e kërkesës zyrtare nga AKP-ja.”.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Publike e Arsimit të Lartë, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si dhe institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla